

DEKLARATË

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë u njoh me deklaratën e Kuvendit të Serbisë, e cila shprehet në mënyrë të njëanshme mbi statusin e ardhshëm të Kosovës, në suazën e Unionit Serbi Mali i Zi.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë e konsideron këtë Deklaratë si një kthim të rrezikshëm prapa, tek politikat e dështuara nacionaliste serbomadhe, të cilat çuan në procese të dhunshme gjatë shpërbërjes së Federatës Jugosllave në dekadën e fundit, duke rrezikuar seriozisht stabilitetin e të gjithë rajonit.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë gjykon se qëndrime të tilla, të ngritura mbi reminishenca të së kaluarës dhe mbi frymën e konfliktualitetit, përbëjnë një përpjekje për të ndërprerë dinamikën e procesit të dialogut, paqes, stabilitetit dhe sigurisë në rajon, që do të çonin drejt integritetit tërësor të tij në strukturat e Bashkimit Europian. Në këtë këndvështrim, Kuvendi vlerëson se deklarime të tilla juridikisht të pabaza nuk përkojnë me frymën e Rezolutës 1244 dhe me përpjekjet e mëdha të bashkësisë ndërkombëtare dhe UNMIK-ut në Kosovë.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vlerëson se qëndrimet konstante të politikës euroatlantike për ardhmërinë e Kosovës janë të qarta dhe në zhvillim progresiv. Statusi i saj do të përcaktohet në funksion të ecurisë së proceseve dhe institucioneve demokratike atje, në frymën e bashkëjetesës etnike, të së drejtës së patjetërsueshme të vetëvendosjes së popujve, interesave të paqes dhe sigurisë në rajonin e Europës Juglindore. Ajo çka Kosova ka arritur me mbështetjen e fuqishme të komunitetit ndërkombëtar, është tashmë pjesë e një procesi të pakthyeshëm.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë fton Kuvendet e Serbisë dhe të Kosovës dhe institucionet e tjera që në një frymë realiste dhe integruese europiane, me ndërmjetësimin e SHBA-së dhe Bashkimit Europian të shtojnë përpjekjet e tyre për fillimin e dialogut në përputhje me frymën dhe axhendën e Samitit të Selanikut. Një gjë e tillë do të ishte në interes të paqes dhe sigurisë në rajon ashtu edhe të zgjidhjes përfundimtare të Statusit të Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë rikonfirmon qëndrimet e tij të mëparshme dhe shpreh bindjen se bashkëpunimi i të gjithë faktorëve relevantë politikë në Kuvendin e Kosovës me UNMIK-un do të garantojë normalitetin institucional dhe respektimin e të gjithë etnive përbërëse të Kosovës.